

# Shënime mbi plotësimin e FORMULARIT TË KËRKESËS PRONËSORE NË PROCESIN E LIKUIDIMIT

## 1. HYRJE

Shënimet në vijim jepen për të ndihmuar pretenduesit në plotësimin e Formularit të Kërkesës Pronësore (L25b Dëshmia e Interesit) në Likuidim. Nëse jeni në dyshim lidhur me ndonjë aspekt të kërkesës suaj, ne ju këshillojmë të kërkonti këshillë dhe ndihmë juridike të pavarur. Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk mund të ofrojë ndihmë të tillë.

Vëmendje të posaçme duhet ti kushtohet detyrimit për nënshkrimin e Formularit të Kërkesës. Faksat dhe kopjet janë të pranueshme, por Autoriteti i Likuidimit rezervon të drejtën të kërkojë origjinalin në çdo kohë.

Keni kujdes të **mos përdorni** këtë formular për kërkesa lidhur me përfshirjen në listat e punëtorëve për pjesëmarrje në 20% të të ardhurave që rrjedhin nga Privatizimi apo Likuidimi i Ndërmarrjes Shoqërore. Nëse parashtroni një kërkesë të tillë nëpërmjet këtij formulari ajo nuk do të shqyrtohet.

Vëreni re, në krah të majtë janë shënuar referencat përkatëse ligjore për llojin respektiv të kërkesës (Neni 40.1.5 dhe neni 40.1.8 i Shtojcës së Ligjit mbi AKP-në).

### 1.1 EMRI I NDËRMARRJES SHOQËRORE

Emri i Ndërmarrjes Shoqërore është i domosdoshme të ceket pasi vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohet dhe të përcaktohet kërkesa juaj më pas, për të bërë të mundur shqyrtimin e saj nga Autoriteti i Likuidimit kompetent.

### 1.2 EMRI DHE ADRESA E PRETENDUESIT

PARASHTRUESI i KËRKESËS është person fizik apo juridik i cili ka pretendim ndaj ndërmarrjes shoqërore.

Nëse jeni person fizik ju lutemi shkruani në kutinë përkatëse emrin e plotë, adresën postare dhe numrin kontaktues të telefonit fiks dhe mobil, nëse kjo është e mundur.

Nëse jeni person juridik ju lutemi shkruani emrin e regjistruar (dhe çfarëdo emri tjetër alternativ), adresat postare të regjistruara, numrin e telefonit dhe emrin e personit kontaktues.

## 2. LLOJI DHE SHUMA E KËRKESËS

Zgjedhni llojin që i përgjigjet më së miri KËRKESËS dhe shkruani shumën e plotë përkrah. Nëse shuma e plotë është e përbërë psh. nga më shumë se një aset, bashkangjitni një listë të ndarë e cila i identifikon asetet e veçanta, vlerat e tyre dhe shumën e plotë, njëjtë siç është dhënë në formular. Nëse nuk është e mundur në të gjitha rastet të jepet vlera e saktë, atëherë shkruani një vlerë të përafërt dhe përshtuani atë si të përafërt.

## 3. PRONARËT E ASETEVE

Ju lutemi siguroni (në fletë të ndarë) informata të rëndësishme lidhur me asetet (patundshmëritë) për të cilat pretendohet pronësia (vendndodhjen fizike, numri i regjistrimit kadastral, etj) në mënyrë që të

mund të identifikohen fizikisht. Nëse është e mundur, jepni gjithashtu një vlerësim të vlerave individuale të secilës pasuri.

Ju gjithashtu duhet të siguronit prova për të dëshmuar pronësinë dhe posedimin tuaj mbi atë pasuri (aset).

#### **4. PRONËSIA E NDËRMARRJES**

Shënimi në kutinë përkatëse cilësinë në të cilin ju besoni se zotëroni pronësinë e ndërmarrjes si psh. pronarë, themelues apo partner. Nëse besoni se jeni pronar i ndërmarrjes (p.sh. aksionar) ju duhet të ofroni fakte mbi pronësinë tuaj, në veçanti:

- (i) ligjet në bazë të cilave ju keni blerë aksionet;
- (ii) kopjet e certifikatave të regjistrimit
- (iii) detajet e vlerës/pjesës që ju keni dhënë për aksionet (për shembull çfarëdo investimi apo borxhi që është dhënë për aksionet, përfshirë kopjet e marrëveshjeve të tilla) dhe faktet e pagesës në të vërtetë, p.sh. transfereve bankare,
- (iv) fakte se aksionet janë emetuar në mënyrë valide dhe se transformimi nga ndërmarrja shoqërore në shoqëri aksionare është bërë në mënyrë valide, si dhe
- (v) vlerën monetare të kërkesës.

#### **5. VEPRIMET/PROCEDURAT E MËPARSHME TË NDËRMARRA PËR REALIZIMIN E KËRKESËS**

Në kutinë e veçantë me titullin e mësipërm, pretenduesi duhet të bëjë të ditur nëse ka ndërmarrë më parë ndonjë veprim ndaj Ndërmarrjes apo Agjensisë, apo ka filluar ndonjë procedurë gjyqësore për realizimin e kërkesës në fjalë. Veprimi mund të jetë, paraqitja e mëparshme e kërkesës në Ndërmarrjen Shoqërore, ish-Agjensinë Kosovare të Mirëbesimit, apo Agjensinë Kosovare të Privatizimit. Në secilin rast nevojitet të bashkangjiten dokumente për të identifikuar dhe provuar veprimin e ndërmarrë apo procedurën e filluar.

#### **6. DOKUMENTET MBËSHTETËSE**

Shkruani këtu një përmbledhje të dokumenteve që i bashkangjiten formularit në mbështetje të kërkesës tuaj. Nëse hapësira në formular për të paraqitur të gjitha dokumentet e bashkangjitura është e pamjaftueshme ju lutem përdorni një letër shtesë.

**Vëni re se:** Mos parashtrojeni/bashkëngjitja e dokumentacionit mbështetës kërkesës tuaj, kërkesa juaj do të konsiderohet si e papranueshme dhe rrjedhimisht nuk do të shqyrtohet/vlerësohet nga ana e Autoritetit të Likuidimit, gjë e cila vlen edhe për kërkesat e pakompletuara të cilat parashtrohen /dërgohen përmes postës.

**MOS BASHKANGJITNI DOKUMENTE ORIGJINALE** – vetëm kopjet të cilat i keni vërtetuara nga origjinali te shërbimi i noterisë – Noteri.

#### **7. DEKLARATË MBI VËRTETËSINË**

Ju lutemi siguroni që kjo deklaratë të plotësohet. Shkruani emrin e pretenduesit (personi fizik apo juridik). Nëse kërkesa paraqitet nga një person i autorizuar në emër të pretenduesit, personi i autorizuar duhet gjithashtu të nënshkruajë. Autorizimi i vërtetuar ligjërisht duhet të bashkëngjitet formularit. Në fund, nënshkrimet duhet të jenë origjinale të shkruara me dorë.

**Autoriteti i Likuidimit rezervon të drejtën që kërkesat e panënshkruara apo të paplotësuara të mos i marrë në konsideratë.**

**Vërejtje: Cilido person që me vetëdije paraqet kërkesë e cila është falso do të ndiqet penalisht.**